



Çdo ditë është Ashura dhe çdo tokë është Kerbela

© dielli.net

كُلُّ يَوْمٍ عَاشُورَاءُ وَكُلُّ أَرْضٍ كَرْبَلَاءُ



Çka është Ashura?

Në muajin e Muharemit të vitit 61 Hixhër (përafërsisht 20 tetor 680), është shfaqur një ngjarje në një vend të Irakut, të quajtur Kərbela, afër bregut të lumit Euftrat. Për historinë e asaj kohe, kjo ishte një ngjarje e parëndësishme. Një ushtri e madhe, e cila ishte mobilizuar nga regjimi i Emevitëve, rrethoi një grup të vogël që numëronin më pak se njëqind persona dhe i bënë presion ndaj tyre për të shprehur besnikërinë ndaj Kalifit të kohës dhe t'i nënshtrohen autoritetit të tij. Grupi i vogël rezistoi dhe pasoi një betejë të ashpër, në të cilën u vranë të gjithë.

Në atë kohë është menduar se kjo betejë do të harrohet me kalimin e kohës dhe se do të zbehet kujtimi për të, sikur që

janë harruar betejat e vogla të ngjashme që kanë ndodhur në ato kohëra. Por, beteja që kishte ndodhur më 10 Muharem, ishte shndërruar në një zjarr sinjalizues dhe një inspirim për gjeneratat e ardhshme.

Kush është Hyseini?

Udhëheqësi i një grupi të vogël të njerëzve që janë martirizuar në Kərbela, nuk ishte askush tjetër, veçse Imam Hyseini (a.s.) i biri i Imam Ali ibni Ebi Talibit (a.s.) dhe nipi i Profetit të Shenjtë (s.a.a.). Kush ishte Hyseini?. Ai ishte biri i Hz Fatimes (a.s.), dhe ai për të cilin Profeti i Shenjtë (s.a.a.) ka thënë: “Hyseini është prej meje dhe unë jam prej Hysejnit. Allahu e dashuroftë çdokënd që e dashuron atë”

Me ndërrimin e jetës së Imam Hasanit (a.s.) në vitin 50 Hixhri, Imam Hysejni (a.s.) u bë lideri i familjes së Profetit të Shenjtë (s.a.a.). Ai e respektonte marrëveshjen e paqes të nënshkruar në mes Imam Hasanit (a.s.) dhe Muavijes, dhe përkundër insistimit të ithtarëve të tij, ai nuk kishte ndërmarrë asnjë aktivitet për të ndryshuar status quo-në politik të asaj kohe. Përkundrazi, ai vazhdonte për të bartur përgjegjësisë ndaj kërkesave fetare të njerëzve dhe në këtë drejtim ishte i shquar me diturinë, devotshmërinë dhe zemërgjerësinë e tij. Një shembull të perceptimit të tij të thellë, mund të vërejmë në duanë e tij të ditës së Arefes, ku i shpjegon atributet e Allahut:

“O Allah, si mund të jepet argument për ekzistimin Tënd, nga ana e një qenies, kur ekzistenca e gjithëmbarshme e tij varet prej Teje? Kur ke qenë i zhdukur, ashtu që të na duhet një dëshmi dhe një mendje për t’i drejtuar njerëzit kah Ti? Dhe, kur ishe Ti larg, ashtu që shenjat dhe përfundimet t’i mundësojnë njerëzve të komunikojnë me Ty? I verbër qoftë syri që nuk të vëren Ty, ndonëse Ti e vështron atë. Çka ka gjetur ai, të cilit i mungojë? Dhe, çka i mungon atij që të gjen Ty? Sigurisht, që kush tenton dhe ka prirje për tjetrin, përveç Teje, do të jetë i humbur.”

Në anën tjetër e kemi Jezidin, babai (Muavije) dhe gjyshi (Ebu Sufjan) i të cilit kanë qenë kundërshtarët kryesor të Profetit dhe që janë munduar gjithmonë për ta sabotuar misionin e tij. Këta i treguan ngjyrat e tyre të vërteta duke lexuar këtë poemë:

Beni Hashimi luajti një lojë për të arritur mbretërinë.

Nuk ka pasur as lajme nga Zoti as ndonjë shpallje.

Mesudi shkruan se Jezidi ishte një person i dhënë mbas epsheve, pirjes së venës dhe luajtjes me shtazë. Nuk është për t’u çuditur, kur Imam Hyseini (a.s.) iu përgjigj Jezidit në këtë mënyrë, në kohën kur kërkonte dhënien e besnikërisë ndaj tij:

“Ne jemi familja e Profetësisë, burimi i pejgamberllëkut, vendi i zbritjes së engjëjve, përmes neve Allahu ka filluar shpërndarjen e dhuntive dhe përmes neve i plotësoi dhuntitë e Tija, ndërsa Jezidi është mëkatar, pijanec, vrasës i njerëzve të pafajshëm dhe njëri që kënaqet haptas duke kryer vepra mëkatore. Një person si unë, kur nuk mund t’i shprehë besnikërinë një personi si ai...”

Revolucioni i Imam Hysejnit (a.s.) ishte një lëvizje Islamike nën udhëheqjen e liderit të madh Islam. Ligjet dhe parimet Islame kërkonin që Imam Hysejni (a.s.) duhej të jepte vërejtje Ummetit Islam në lidhje me situatën e rëndë në të cilën ndodhej dhe t’i dalë përpara udhëheqësit devijues. Sikur që e cekti edhe vetë Imam Hysejni (a.s.), kur doli nga Medina për të marrë rrugën e Irakut për herë të fundit,

“Unë nuk po ngrihem kundër Jezidit, si një person të paturp dhe arrogant, apo si një i lig ose tiran. Unë po ngrihem kundër Jezidit sepse qëllimi im është reformimi i Ummetit të gjyshit tim. Unë dëshiroj të urdhëroj të mirën dhe ta ndaloj të keqen”

Imam Hyseini (a.s.) u mbyt në fushën e betejës duke qenë në sexhde. Koka e tij ishte ndarë prej trupit të tij në fushën e Kerbelasë. Pastaj është vendosur në një shtizë dhe në këtë mënyrë është parakaluar nëpër fshatra e qytete deri në Damask, ku është prezantuar përpara këmbëve të Jezidit.

Pse të kujtohet Ashura?

Pse Imam Hysejni (a.s.) konsiderohet si *“lideri i martirëve”*? Sepse, ai nuk ishte vetëm një viktimë e një udhëheqësi ambicioz. Nuk ka dyshim se tragjedia e Kerbelasë, në aspektin e vrasësit, është një akt kriminel dhe i tmerrshëm. Por, në aspektin e vetë Imam Hysejnit (a.s.), paraqet një konfrontim të vetëdijshëm dhe një rezistim heroik për shtëpinë e shenjtë. Tërë populli dështoi në kryengritjen kundër Jezidit.. Ata ishin dorëzuar dëshirës së tij, dhe ishte në rritje devijimi me prapavajtje në drejtim të rregullave para-islamike.

Në një situatë të tillë, pasiviteti i Imam Hysejnit (a.s.) do të rezultonte me fundin e Islamit dhe Imam Hysejni (a.s.) e morri mbi vete përgjegjësinë e tërë popullit. Tragjedia më e madhe është se njëri që u ngrit në këmbë për shkaqe më fisnike dhe për mbrojtjen e Islamit, ishte masakruar në mënyrë aq të vrazhdë.

Për këtë arsye, për çdo vjet përkujtohet sakrificën e Imam Hysejnit (a.s.) në tërë botën Islame. Pikëllimi ynë nuk do të pakësohet asnjëherë, përderisa e rikujtojmë tragjedinë. Sikur që ka thënë Allame Ikbali:

Unë jam ai që loton në gjendje të mjerë për martirin e Kerbelasë

A nuk do të shpërblehem prej Mbajtësit të Kevserit

Komemoracioni i Ashures që mbahet çdo vit më 10 Muharem, na shërben për të na rikujtuar sakrificën e familjes së Profetit (s.a.a.). Gjithashtu, na bën me dije për njerëzit, e asaj dhe të gjitha kohëve, që mundohen ta shkatërrojnë Islamin, familjen e Profetit (s.a.a.) dhe të gjitha gjërat për të cilat kanë luftuar ata. Dhe në anën tjetër, na bën me dije për të gjithë ata që e kanë parë e dëgjuar, por nuk kanë bërë asgjë.